



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.04.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i projektprogramit 6-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 15 prill – 24/31 maj 2019
2. Miratimi i projektkalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 15 prill – 10 maj 2019.
3. Raportimi periodik lidhur me zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit për rekomandimet e Raportit 2018 të Komisionit European, periudha 1 janar – 28 shkurt 2019.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Zëvendëskryetare e Kuvendit
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Niko Peleshi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën dhe të Drejtat e Njeriut
Senida Mesi -	Zëvendëskryetare e Komisionit për Integrimin European
Klodiana Spahiu -	Zëvendëskryetare e Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë
Milva Ekonomi -	Zëvendëskryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Mungojnë:

Elisa Spiropali –	Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin
Arben Ahmetaj -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Fillojmë mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve me këtë rend dite: Miratimi i projektprogramit 6-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 15 prill – 25/31 maj 2019, miratimin e kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën në vazhdim dhe Raportimin periodik lidhur me zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit për rekomandimet e Raportit 2018 të Komisionit European, periudha 1 janar – 28 shkurt 2019.

Me projektprogramin dhe projektkalendarin besoj se jeni njohur në rrugë elektronike paraprakisht.

Projektkalendari përfshin veprimtarinë në komisione dhe në seancë plenare. Në kalendar janë parashikuar 3 seanca plenare, respektivisht data 18 prill, ora 10.00, 25 prill, ora 10.00. Lidhur me seancën e tretë të radhës, i takon të jetë në datën 2 maj, por data 1 maj, e mërkurë, është ditë pushimi, gjithashtu edhe data 29 prill, e hënë, është ditë pushimi dhe komisionet kanë në dispozicion vetëm ditën e martë, datë 30 prill për të punuar. Në kushte të tilla propozimi për seancën e tretë bëhet për datën 9 maj, ora 10.00.

Lidhur me pikën e tretë në rend dite, kemi raportimin periodik që bëjnë shërbimet e Kuvendit lidhur me zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit për rekomandimet e Raportit 2018 të Komisionit European. Raportimi përfshin periudhën janar – shkurt 2019. Keni mendime, sugjerime?

Taulant Balla – Jemi dakord me planifikimin e raportimeve. Do të dëshiroja të thosha se për seancën e caktuar në datë 9 maj kemi aktivitete me rastin e ditës së Evropës, ndaj seanca plenare të planifikohet për datën 8 maj e mërkurë, ora 10.00.

Ulsi Manja – Lidhur me projektvendimin “Për strategjinë e edukimit ligjor të publikut në Republikën e Shqipërisë”, të planifikohet për seancën e radhës, pasi komisioni i Ligjeve e miratoi sot. Është një nga projektligjet e paketës së dytë të ligjeve të Reformës në Drejtësi dhe nëse ka hapësirë të përfshihet në seancë.

Taulant Balla – Nga planifikimi është se deri në seancën e datës 8 maj ne t’i kemi mbyllur pothuajse tërësisht, pjesën më të madhe të këtyre ligjeve që lidhen me paketën e dytë të Reformës në Drejtësi. Kjo përkon dhe me datën 9 maj që është dita e Europës, ku Shqipëria raporton me krenari për përmbushjen e paketës së dytë të Reformës në Drejtësi.

Ulsi Manja – Këtë diskutim e kam bërë edhe me Drejtorinë e Seancës Plenare. Ne në datën 9 maj do të duhet të votojmë në Kuvend të tre projektligjet e fundit të paketës së dytë të Reformës në Drejtësi. Njëra u mbyll sot, ndërsa dy të tjerat mbyllen javën që vjen.

Gramoz Ruçi – Bëjini çdo njërën në një seancë dhe mos i lini për një seancë të vetme të tëra.

Ulsi Mnja – Mund të lëmë për datën 8 maj, njërën, të fundit.

Taulant Balla – Do t'u kërkoja kryetarëve të komisioneve edhe Zëvendëskryetares që në takimin e sotëm të Këshillit Kombëtar të Integritetit në përmbushje dhe të detyrës specifike të secilit, të jeni të gjithë prezent, po të kemi parasysh çështjet shumë të rëndësishme që Këshilli Kombëtar i Integritetit ka sot në axhendë.

Gramoz Ruçi – Dakord me të gjitha parashtrimet. Dita e mërkurë datë 8 maj, ora 10.00 të jetë seanca e fundit të këtij kalendari 3-javor, dy datat e tjera të mbeten siç janë parashikuar, 18 dhe 25 prill, e enjte ora 10.00. Këtu e mbyllim këtë mbledhje të Konferencës së Kryetarëve. Faleminderit.

MBLEDHJA MBYLLET